



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2019:198356

Datë: 05.03.2024

Numri i dokumentit: 05411095

**C.nr.495/2017**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil**, me gjyqtarin Fuad Haliti, në kontestin e paditësve F.S dhe J.A rr.”Aristidh Kola” nr.99, Mitrovicë Jugore, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av.Avdi Dinaj nga Mitrovica, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av.Arbnor Murturi nga Prishtina, me objekt të kontestit Vërtetim i pronësisë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 05.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZHET** kërkesëpadia e paditësve **F.S dhe J.A**, nga Mitrovica, të cilët kanë kërkuar që të vërtetohet se **F.S** është pronar i objektit – shtëpisë, me oborr dhe t’i njihet e drejta e shfrytëzimit të përhershëm të pjesës së ngastrës kadastrale nr. P-71208072-03022-33 në sipërfaqe prej 58m<sup>2</sup> Zona Kadastrale në Mitrovicë dhe pjesës së ngastrës kadastrale nr. P-71208072-03022-563 në sipërfaqe prej 336m<sup>2</sup> Zona Kadastrale në Mitrovicë, me masa dhe kufijë, duke filluar nga Veriu nga pika 1 deri në pikën 2 me gjatësi prej 3.02m, nga pika 2 deri në pikën 3 me gjatësi prej 6.79m, nga pika 3 deri në pikën 4 me gjatësi prej 12.01m, nga pika 4 deri në pikën 5 me gjatësi prej 10.27m, nga pika 5 deri në pikën 6 me gjatësi prej 3.99m, nga pika 6 deri në pikën 7 me gjatësi prej 5.23m, nga pika 7 deri në pikën 8 me gjatësi prej 2.46m, nga pika 8 deri në pikën 9 me gjatësi prej 5.43m, nga pika 9 deri në pikën 10 me gjatësi prej 8.18m, nga pika 10 deri në pikën 11 me gjatësi prej 10.94m, nga pika 11 deri në pikën 12 me gjatësi prej 10.49m, nga pika 12 deri në pikën 13 me gjatësi prej 0.82m, nga pika 13 deri në pikën 14 me gjatësi prej 0.80m dhe nga pika 14 deri në pikën 1 me gjatësi prej 11.65m, dhe të vërtetohet se **J.A** është pronar i objektit – shtëpisë, me oborr dhe t’i njihet e drejta e shfrytëzimit të përhershëm të pjesës së ngastrës kadastrale nr. P-71208072-03022-33 në sipërfaqe prej 311m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale në Mitrovicë, pjesës së ngastrës kadastrale nr. P-71208072-03022-563 në sipërfaqe prej 128m<sup>2</sup> Zona Kadastrale në Mitrovicë dhe pjesës së ngastrës kadastrale nr. P-71208072-03216-1 në sipërfaqe prej 62m<sup>2</sup> Zona Kadastrale në Mitrovicë me masa dhe kufijë, duke filluar nga Veriu nga pika 1 deri në pikën 15 me gjatësi prej 3.11m, nga pika 15 deri në pikën 16 me gjatësi prej 7.50m, nga pika 16 deri në pikën 17 me gjatësi prej 10.71m, nga pika 17 deri në pikën 18 me gjatësi prej 5.57m, nga pika 18 deri në pikën 19 me gjatësi prej 4.77m, nga pika 19 deri në pikën 20 me gjatësi prej 15.32m, nga pika 20 deri në pikën 21 me gjatësi prej 4.44m, nga pika 21 deri në pikën 22 me gjatësi prej 4.22, nga pika 22 deri në pikën 23 me gjatësi prej 13.00m, nga pika 23 deri në pikën 24 me gjatësi prej 0.30m, nga pika 24 deri në pikën 25 me gjatësi prej 4.79m, nga pika 25

deri në pikën 10 me gjatësi prej 1.73m, nga pika 10 deri në pikën 11 me gjatësi prej 10.94m, nga pika 11 deri në pikën 12 me gjatësi prej 10.49, nga pika 12 deri në pikën 13 me gjatësi prej 0.82m, nga pika 13 deri në pikën 14 me gjatësi prej 0.80m dhe nga pika 14 deri në pikën 1 me gjatësi prej 11.65m, **në tërësi si e pabazuar.**

- II. **OBLIGOHEN** paditësit F.S dhe J.A që në mënyrë solidare t'ia kompensojnë të paditurës shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 405.00€, në afat prej 15 ditësht nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

## Arsyetim

### 1. Pretendimet e palëve

Paditësit S.S dhe J.A me datën 30.08.2017, pranë kësaj gjykate kanë paraqitur padi kundër të paditurve Komuna e Mitrovicës, me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet se paditësi S.S është pronar i objektit – shtëpisë, me oborr, në sipërfaqe të gabariteve sipas ekspertizës dhe i njihet e drejta e shfrytëzimit të përhershëm të paluajtshmërisë të përkufizuar në masa dhe kufij sipas ekspertizës, në pjesët e ngastrave kadastrale P-71208072-03022-208 në sipërfaqe prej 10358m<sup>2</sup> si dhe një pjesë sipas ngastrës kadastrale P-71208072-03022-33, në sipërfaqe prej 1419m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur Tavnik, dhe paditësi J.A është pronar i objektit – shtëpisë, me oborr, në sipërfaqe të gabariteve sipas ekspertizës dhe i njihet e drejta e shfrytëzimit të përhershëm të paluajtshmërisë të përkufizuar në masa dhe kufij sipas ekspertizës, në pjesët e ngastrave kadastrale P-71208072-03022-208 në sipërfaqe prej 10358m<sup>2</sup> si dhe një pjesë sipas ngastrës kadastrale P-71208072-03022-33, në sipërfaqe prej 1419m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur Tavnik.

I autorizuari i paditësve në seancës e datës 26.10.2023 e ka ndryshuar padinë në kuptimin subjektiv për shkak se paditësi S.S ka vdekur, ashtu që në vend të tij do të qëndrojë trashëgimtari i tij F.S, ndryshim të cilin gjykata me aktvendim procedural e lejoj.

I autorizuari i paditësve, në seancën kryesore të datës 27.02.2024, deklaroi se mbetem pranë padisë dhe kërkesës së parashtruar në të, me ndryshim se pas daljes në vend me ekspertin e gjeodezisë është vërtetuar se paditësi F.S sipas gjendjes faktike të treguar mban pjesët e ngastrave kadastrale me nr.3022-33 me sipërfaqe prej 58m<sup>2</sup> dhe pjesën e ngastrës kadastrale me nr.3022-563 në sipërfaqe prej 336m<sup>2</sup> ZK Mitrovicë, në pjesën e truallit i njëjti ka ndërtuar shtëpinë P+1 dhe një garazhd, kurse paditësi J.A sipas gjendjes në vendin e ngjarjes mban pjesët e parcelave kadastrale nr.3022-33 në sipërfaqe prej 311m<sup>2</sup>, pjesën e ngastrës kadastrale nr.3022-563 në sipërfaqe prej 128 m<sup>2</sup>, si dhe pjesën e parcelës kadastrale nr.3216-1 me sipërfaqe prej 62 m<sup>2</sup>, ZK Mitrovicë ku ka të ndërtuar shtëpinë P+2 një pjesë P+1 dhe një shupë nga druri, përndryshe këto shtëpi të ndërtuara mbi 70 vite nga shifet me rastin e daljes në vendin e ngjarjes. Si precizim të kërkesës së parashtruar për çka i propozojmë gjykatës që të aprovohet në masat dhe kufijtë për F.S si në pasuesin e parë të faqës 2 të ekspertizës për ngastrën kadastrale nr.3022-33 dhe 3022-563, kurse për paditësin J.A si në pasuesin e dytë të faqës 2 të ekspertizës për ngastrat kadastrale nr.3022-33, 3022-563 dhe 03216-1. Shpenzimet e procedurës i kërkojë.

I autorizuari i të paditurës në seancën kryesore të datës 27.02.2024, deklaroj se e kanë pranuar ekspertizën gjeodezike dhe ndaj të njëjtës nuk kanë vërejtje, pas pranimit të kësaj ekspertize është konstatuar fakti se prona kontestuese, përkatësisht parcelat nr.3022-33, 3022-563 dhe 3216-1 evidentohen në pronësi të paditurës që nga vitet e 70-ta, përkatësisht vitet e 80-ta, prandaj në bazë të këtyre fakteve e paditura kërkon nga gjykata që të lejojë kundëpadi të cilën e paditura e paraqet kundët paditësve dhe me anë të cilës kërkon nga paditësi F.S që të lirojë paluajtshmërinë me sipërfaqe prej 58m<sup>2</sup>, e cila bënë pjesë në parcelën 3022-33 si dhe paluajtshmërinë në sipërfaqe prej 366m<sup>2</sup>, e cila gjendet në parcelën me nr.3022-563, ndërsa paditësi J.A të detyrohet që të lirojë sipërfaqen prej 128m<sup>2</sup>, në parcelën me nr.3022-563 si dhe sipërfaqen 62m<sup>2</sup>, e cila gjendet në parcelën 3216-1, po ashtu siç janë përkufizuar me anë të ekspertizës gjeodezike. Konsiderojmë se paditësit pa ndonjë bazë ligjore i shfrytëzojnë pronat kontestuese për arsye se këto prona gjithëherë janë evidentuar si pronë e të paditurës, andaj duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore i cili përcakton se pronësia nuk mund të fitohet në pronë shoqërore me parashkrim fitues në bazë të mbajtjes. Në fjalën përfundimtare deklaroj se e kundërshtojmë në tërësi kërkesëpadinë për shkak se të njëjtit nuk i kanë vërtetuar faktet thelbësore për njohjen e kërkesëpadisë së tyre duke u bazuar në faktin që kërkesëpadinë e mbështesin në një deklaratë të thjeshtë se pronat kontestuese i kanë blerë nga një person i quajtur Mit Zeka i cili nuk dihet nëse ka qenë pronar legjitim i pronave kontestuese dhe i njëjti nuk ka pasur mundësi që të bartë të drejta pronësore tek paditësit duke mos u vërtetuar fakti nëse vet shitësi i ka poseduar këto të drejta. Shpenzimet e procedurës i kërkojë.

## ***2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor***

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: ekspertiza gjeodezike e dt.12.12.2023 e ekspertit gjeodet Afrim Sadiku, ekstrakti nga regjistrit civil për F.S me nr.E27418028, certifikata e vdekjes për S.S nr.V10630344, certifikatat e pronave për ngastrën kadastrale 03022-33, 03022-563 dhe 03216-1, fatura e tatimit në pronë për S.S e datës 09.02.2016, deklarata mbi dakordimin e borxhit nr.17262 e datës 27.07.2016, fatura e energjisë elektrike për S.S e datës 23.03.2017, dëftesa e energjisë elektrike e dt.02.07.2017, përgjigje në kërkesë nr.15-030/01/0066897/23 e datës 23.12.2022, përgjigjja në kërkesë nr.15-942/03-0087012/2 e datës 11.12.2023.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku duke gjetur se kërkesëpadia e paditësve është **e pa bazuar**.

## ***3. Faktet***

Me leximin e ekspertizës gjeodezike e dt.12.12.2023 e ekspertit gjeodet Afrim Sadiku, gjykata vërtetoi faktin se ngastra kadastrale nr. 03022-33, lloji i njësisë parcelë, është pronë shoqërore, zona urbane, në vendin e quajtur Tavnik, lloji i shfrytëzimit të kësaj parcele është bujqësore,

shfrytëzimi aktual është arë, kualiteti i klasës është arë e klasës 2 dhe ka sipërfaqe prej 1419m<sup>2</sup>, ngastra kadastrale me nr.03022-563, lloji i njësisë parcelë, është pronë shoqërore, zona urbane, në vendin e quajtur Tavnik, lloji i shfrytëzimit të kësaj parcele është bujqësore, shfrytëzimi aktual është arë, kualiteti i klasës është arë e klasës 2 dhe ka sipërfaqe prej 9048m<sup>2</sup>, ngastra kadastrale nr.03216-1, lloji i njësisë parcelë, është pronë shoqërore, zona urbane, në vendin e quajtur Tavnik, lloji i shfrytëzimit të kësaj parcele është bujqësore, shfrytëzimi aktual është arë, kualiteti i klasës është arë e klasës 3 dhe ka sipërfaqe prej 2951m<sup>2</sup>. Paditësit F.S 1/1 sipas gjendjes faktike i mbanë pjesët e parcelave kadastrale me nr.3022-33 me sipërfaqe prej 58m<sup>2</sup>, dhe pjesën e parcelës kadastrale me nr.3022-563 me sipërfaqe prej 336m<sup>2</sup>, ZK Mitrovicë dhe ka të ndërtuar një shtëpi P+1 dhe një garazhë. Paditësi J.A 1/1 sipas gjendjes faktike i mban pjesët e parcelave kadastrale nr.3022-33 me sipërfaqe prej 311m<sup>2</sup>, pjesën e parcelës kadastrale nr.3022-563 në sipërfaqe prej 128m<sup>2</sup>, dhe pjesën e parcelës nr.3216-1 me sipërfaqe prej 62m<sup>2</sup>, ZK Mitrovicë dhe ka të ndërtuar shtëpi P+2 dhe një pjesë P+1 dhe një shupë nga druri.

Me leximin e certifikatave të pronave për ngastrat kadastrale 03022-33, 03022-563 dhe 03216-1, gjykata vërtetojë faktin se të njetat evidentohen si pronë e të paditurës Komuna e Mitrovicës së Jugut.

Me leximin e përgjigjes në kërkesë nr.15-030/01/0066897/23 e datës 23.12.2022 dhe përgjigjes në kërkesë nr.15-942/03-0087012/2 e datës 11.12.2023, gjykata vërtetojë faktin se ngastrat kontestuese janë pronë e Komunës së Mitrovicës Jugore.

Me leximin e ekstraktit nga regjistrit civil për F.S me nr.E27418028 dhe certifikatën e vdekjes për S.S nr.V10630344, gjykata vërtetojë faktin se F.S është i biri i S.S i cili ka vdekur me datën 18.12.2020.

Me leximin e faturës së tatimit në pronë për S.S e datës 09.02.2016, gjykata vërtetojë faktin se i njëjti është i regjistruar si tatim pagues i pronës pranë Komunës së Mitrovicës.

Me leximin e deklaratës mbi dakordimin e borxhit nr.17262 e datës 27.07.2016, faturës së energjisë elektrike për S.S e datës 23.03.2017 dhe dëftesa e energjisë elektrike e dt.02.07.2017, gjykata vërtetojë faktin se i njëjti është shfrytëzues i energjisë elektrike në adresën rr.”Aristidh Koja” në Mitrovicë.

#### **4. Ligji i aplikueshëm**

Në këtë çështje Kontestimore u zbatuar Ligji mbi Marrëdhëniet Pronësore i vitit 1980 dhe Ligjit mbi Detyrimet i vitit 1978, si ligje që kanë qenë në fuqi kur është krijuar marrëdhënia juridike.

Në bazë të nenit 20 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësore, parashihet që “*e drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgimi.*”

Në bazë të nenit 28 paragrafi 4 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësore, parashihet që *“Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh.”*

Në bazë të nenit 29 i po këtij ligjit, parashihet se *“Mbi sendin në pronësin shoqërore e drejta e pronësisë nuk mund të fitohet me parashkrimin fitues.”*

Në bazë të nenit 30 paragrafi 1 i po këtij ligjit parashihet që *“Koha e nevojshme për parashkrimin fitues fillon të ecë nga ajo ditë kur mbajtësi ka marrë në posedim sendin dhe mbaron me kalimin e ditës së fundit të kohës së nevojshme për parashkrimin fitues.”*, ndërsa paragrafi 2 i po këtij neni parashihet që *“Në kohën e nevojshme për parashkrimin-fitues llogaritet edhe koha për të cilën paraardhësit e mbajtësit të tanishëm kanë mbajtur sendin si mbajtës me mirëbesim dhe të ligjshëm, respektivisht si mbajtës me mirëbesim.”*

Në bazë të nenit 33 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësore, parashihet që *“Në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj.”*

Në bazë të nenit 24 paragrafi 1 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësore, parashihet që *“Personi që mund të jetë bartës i së drejtës së pronësisë, e që ndërton ndërtesën ose godinën tjetër (objektin ndërtimor) në tokën mbi të cilën tjetri ka të drejtën e pronësisë (ndërtuesi), fiton të drejtën e pronësisë edhe mbi tokën në të cilën është ndërtuar objekti ndërtimor, si dhe mbi tokën që është e domosdoshme për përdorimin e rregullt të këtij objekti ndërtimor, po qe se nuk ka ditur, as që ka mundur të dinte se po ndërton në token e huaj, kurse pronari i tokës ka pasur dijeni për ndërtimin dhe nuk ka kundërshtuar menjëherë.”*

## **5. Vlerësimet përfundimtare të gjykatës**

Pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar dhe se duke u bazuar në dispozitat ligjore të cituara më lartë, e njëjta duhet të refuzohet.

Gjykata konstaton se paditësit nuk e kanë fituar të drejtën e pronësisë mbi shtëpitë e ndërtuara në ngastrat kontestuese e as të drejtën e shfrytëzimit të ngastrave kontestuese mbi asnjërën bazë të paraparë me nenin 20 paragrafi 1 dhe neni 24 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësore. Gjykata, konstaton se sipas Ligji mbi Marrëdhëniet Pronësore i vitit 1980 por edhe Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore, kushtet për bartjen e pronësisë mbi sendet e paluajtshme janë puna juridike në këtë rast kontrata dhe regjistrimi në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri apo me ligjin e vjetër regjistrimi në regjistrin publik. Në rastin konkret, paditësit nuk i kanë prezantuar gjykatës asnjë kontratë të shitblerjes së ngastrave kontestuese, përkundër faktit se pretendojnë se të njëjtat i kanë blerë nga personi i quajtur Mit Zeka.

Gjykata, duke mos qenë e lidhur me bazën juridike të kërkesëpadsisë vlerësojë edhe bazën e parashkrimit fitues pas mbajtjes me mirëbesim, mirëpo pas administrimit të provave, gjykata vërtetohet faktin se prona konstestuese është pronë e Komunës së Mitrovicë, andaj në pronë publike sipas dispozitave ligjore të Ligji mbi Marrëdhëniet Pronësore i vitit 1980 nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë me parashkrim fitues. Sa i përket ndryshimeve të ligjit për marrëdhëniet pronësore të vitit 1996, gjykata thekson faktin se në vitin pas vendosjes së administratës ndërkombëtare në Kosovë në vitin 1999, është nxjerrë Rregullorja e UNMIK-ut, nr.1999/24, për ligjin në fuqi në Kosovë, me të cilin në nenin 1, paragrafi 1 është përcaktuar se ligji në fuqi në Kosovë përfshinë legjislacionin në fuqi i Kosovës më 22 mars 1989 dhe se ligjet pas vitit 1989 mund të zbatohen vetëm nëse ligjet e viteve deri në vitin 1989 nuk mund ta mbulojnë ndonjë situatë dhe nëse këto ligje nuk janë diskriminuese. Në këtë rast Ligji për Marrëdhëniet Pronësore para vitit 1989 e ka mbuluar mënyren e bartjes së pronësisë mbi paluajtshmëri dhe ka theksuar në mënyrë shprehimore se mbi sendin në pronësi shoqërore, e drejta e pronësisë nuk mund të fitohet me parashkrim fitues. Ndërsa Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore e rregullon vetëm fitimin e pronësisë mbi pronën private dhe nuk bënë fjalë për pronat shoqërore, përkatësisht neni 1 paragrafi 5 i këtij ligji parasheh që dispozitat e këtij ligji nuk aplikohen në të drejta sendore publike, andaj gjykata vlerëson se as afatet e parashkrimit nuk janë të vlefshme kur kemi të bëjmë me pronën shoqërore.

Sa i përket bazës juridike që paditësve të ju njihet e drejta e shfrytëzimit në paluajtshmërive kontestuese, mbi bazën e ndërtimit në token e tjetrit komfor neni 24 paragrafi 1 i Ligjit për marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike, gjykata konstaton se në bazë të kësaj dispozite kusht për fitim e pronësisë mbi tokën e tjetrit është që ndërtuesi mos ta ketë ditur dhe as që ka mundur të dinte se po ndërton në tokën e huaj, kurse pronari i tokës ka pasur dijeni për ndërtimin dhe nuk ka kundërshtuar menjëherë. Andaj, në bazë të provave të administruar nuk mund të vërtetohet nëse pronari Komuna e Mitrovicës ka qenë në dijeni kur paditësit kanë bërë ndërtime në këtë paluajtshmëri, si dhe paditësit nuk arritën ta vërtetojnë faktin se të njëjti nuk kanë ditur se mbi tokën e kujt janë duke ndërtuar.

Gjykata konstaton se ligji nuk e njeh institutin e fitimit të të drejtës së shfrytëzimit të paluajtshmërisë mbi bazën e parashkrimit fitues, por vetëm situatën e fitimit të pronësisë mbi bazën e parashkrimit fitues. Kjo për faktin se shfrytëzimi i paluajtshmërisë është e drejtë e cila i takon pronarit dhe pronari i paluajtshmërisë mund të disponoj me pronën e tij në mënyrë absolute dhe atë mund ta posedojë ta përdorë por ka të drejtën edhe ta bartë tek personat e tjerë. Pra, bartja e të drejtës për shfrytëzimin e paluajtshmërisë është e drejtë ekskluzive e pronarit të paluajtshmërisë dhe nuk mund gjykata të disponoj me paluajtshmëritë e personave apo t'ia njeh të drejtën e shfrytëzimit personave të caktuar sepse nuk ka autorizimi për një gjë të tillë. Andaj për ta fituar të drejtën e shfrytëzimit të paluajtshmërive kontestuese, paditësit duhet ti drejtohen të paditurës së parë, këtu Komuna e Mitrovicës e cila është pronare e paluajtshmërive dhe ka të drejtë të disponojë me to në mënyrë absolute.

Sa i përket, kërkesëpadsisë së paditësve të të ju njihet e drejta e pronësisë në shtëpitë e banimit, gjykata konstaton se duke marrë parasysh faktin se të njëjtëve nuk i'u takon e drejta e shfrytëzimit të paluajtshmërive mbi të cilat janë të ndërtuara këto shtëpi, nuk i'u takon as e drejta

e pronësisë mbi këto shtëpi sepse të njëjtat nuk janë ndërtuar komfor dispozitave ligjore, andaj për këtë çështje paditësit duhet të ndjekin rrugët administrative pranë organeve kompetente të cilat kanë juridiksion të vendosin në procedurën e legalizimit apo pronësisë së shtëpive të ndërtuara në pronë shoqërore, dhe të cilët kanë autorizimet e nevojshme që të japin pronën e tyre në shfrytëzim dhe të lejojnë ndërtime në pronën e tyre.

Gjykata, gjatë seancës kryesore nuk e lejoj kundërpadinë e paraqitur nga ana e të paditurës sepse në bazë të nenit 256 paragrafi 2 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, për paraqitjen e kundërpadisë në këtë fazë u kërkuar dhënia e pëlqimit nga ana e paditësve, pëlqim të cilin paditësit nuk e dhanë.

Lidhur me shpenzimet procedurale, gjykata vendosi komfor nenit 463 të LPK-së, duke marrë parasysh se asnjëra palë nuk i kërkojë shpenzimet procedurale.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**  
**C.nr.495/2017, datë05.03.2024**

**Gjyqtari**  
**Fuad Haliti**

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.